



VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
 ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
 GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
 FERIZAJ I UROŠEVAC

[Signature]

Më
 Data 30-01-2018

P.nr.2399/17

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Penal gjyqtarja individuale Hakile Ilazi, me procesmbajtësen-praktikantja Albulena Topalli, në lëndën penale kundër të pandehurit [REDACTED], i akuzuar sipas Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1742-7/2017, të dt.26.09.2017, për veprën penale lëndimi lehte trupor nga neni 188 par. 1 të KPK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP PP/II.nr.1742-7/2017, të dt.26.09.2017 për dhënien e urdhrit ndëshkimor dënim me gjobë, gjykata me dt.20.10.2017 mori këtë:

AKT GJYKIM

PRANOHET, kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1742-7/2017, të dt.26.09.2017, dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri [REDACTED] me vendbanime në rrugën [REDACTED] [REDACTED] i lindur me [REDACTED] në [REDACTED], nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], ka te kryer shkollën fillore, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORË

Se me datë 25.07.2017, rreth orës 17.30, në rrugën ‘Lubeteni’, në Ferizaj, i pandehuri lehta e dëmtoni të dëmtuarin [REDACTED], në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje mes tyre të ndodhur aty për aty në komunikacion, e sulmon fizikisht të dëmtuarin duk e goditur me grushtua, e që bazuar në mendimin dhe konstatimin e ekspertit mjeko-ligjor të dt.13.09.2017, lëndime të tilla bejn pjese në dëmtime te lehta trupore dhe me pasoja te përkohshme per shëndetin.

-me të cilën ka kryer veprën penale lendimi lehte trupor nga neni 188 par. 1 të KPK-së.

Prandaj gjykata në bazë të nenit 4,7,17,21,41,46,73, të KPRK-së si dhe nenit 495, të KPPK-së

G J Y K O N

Të pandehurin, me dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) €, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rast se dënimi me gjobë nuk mundë të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjti do ti shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do ti llogaritet 1(një) ditë burg.

I dëmtuari [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] komuna [REDAKTUAR] për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhezohet ne kontest civil.

Obligohet i pandehuri qe ne emer te shpenzimeve te procedures te paguaj shumen prej --- dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 20 (njetete) € në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr.1742-7/2017, të dt.26.09.2017 ka akuzuar të pandehurin [REDAKTUAR], për vepër penale lendimi lehte trupor nga neni 188 par. 1 të KPRK-së, dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrit ndëshkimor PP/II.nr.1742-7/2017, të dt.26.09.2017, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i pandehuri.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 par 1.të KPPK-së.

Që në fazën e administrimit të provave të merret mendimi i oficerit si mendimi dhe konstatimi i ekspertit ligjori i datës 13.09.2017, vërteton se këto prova janë bindëse dhe të bazuara, dhe njëkohësisht vërtetojnë se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqipton dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nen.458,459 dhe 460 të KPPK-së I dëmtuari [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] komuna [REDAKTUAR] për realizimin e kërkeses pasurore juridike udhezohet ne kontest civil.

Konform nenit 450 dhe 451 të KPPK-së gjithashtu obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20€ në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nga arsyet e sipër cekura, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr.2399/17 datë 20.10.2017

Procesmbajtësja
Albulena Topalli

Gjyqtarja Individuale
Hakile Ilazi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit të njëjtës gjykatë.